

KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI

TË SHOQËRISË "BIG ALI DEMI" SH.P.K

Sot me date 18.04.2024 ortaku i shoqerise BIG ALI DEMI shpk, Vladimir Lleshaj dhe e interesuara shoqeria B-Ideal Group e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj u mblodhen per te nenshkruar kontraten e shitjes se kuotave ku:

SHITESI:

Vladimir Lleshaj, i datelindjes 08.04.1978 pajisur me karten e identitetit H80408150T, zoterues i 1 kuote ekuivalente me 49% te kapitalit me vlere 2 450 000 leke.

BLERESI:

Shoqeria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord te nenshkruajne Kontratën e Shitjes të k uotave të kapitalit të Shoqërisë "BIG ALI DEMI" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Neni 1

Marreveshja themelore

Shoqeria "BIG ALI DEMI" sh.p.k, eshte regjistruar ne QKB e pajisur me NIPT L61529002L, me seli ne Njesia Bashkiake Nr.1, Kryqezimi Ali Demi, Rruga Kristaq Capo, Pallati Nr.1, Kati I-re, Tirane, me ortake si me poshte:

Vladimir Lleshaj zoterues i 1 kuote ekuivalente me 49% te kapitalit me vlere 2 450 000 leke

Shoqeria BIGALB GROUP e perfaqesuar nga administratori i saj Znj. Elona Koshi zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 51% te kapitalit me vlere 2 550 000 leke



Ne vendimin date 18.04.2024, asambleja e ortakeve te shoqerise ka miratuar shitjen e kuotave te zoteruara nga pala shitese Vladimir Lleshaj ne favor te pales blerese shoqeria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj dhe konkretisht:

Pala shitese Vladimir Lleshaj i shet pales blerese shoqerise B-Ideal Group 1 kuoea qe perfaqeson pjesmarrjen ne perqindje 49% te kapitalit te shoqerise "BIG ALI DEMI" shpk.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe menyra e likujdimit

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 2 450 000 si me poshte:

Vladimir Lleshaj ka rene dakort ti shesi pales blerese shoqerise B-Ideal Group nëpërmjet shitjes se 1 kuote qe perfaqesojne 49% te kapitalit te shoqerise, kundrejt cmimit 2 450 000 leke shume e cila eshte likujduar nga pala blerese ne favor te pales shitese.

Pas ketij veprimi, shoqeria do do te kete 2 kuota qe do te zoterohen nga ortaket si me poshte:

Shoqeria B-Ideal Group zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 49% te kapitalit me vlere 2 450 000 leke

Shoqeria BIGALB GROUP zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 51% te kapitalit me vlere 2 550 000 leke

Neni 3

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kontrata do te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësit do të kryhet menjehere.

Neni 4

Garancitë



Shitësi në lidhje me kuoten që zotëron, garanton Blerësin:

1. Se është pronar i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuota të shitura.
2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuota të fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.
5. Palet shitesë me nënshkrimin e kësaj kontrate, heqin dorë perfundimisht nga pronësia mbi kuotat që shet, të gjitha të drejtat dhe detyrimet i kalojnë palës blerëse.

Neni 5

Regjistrimi

Regjistrimi i kontrates perkalimin e kuotavenga Shitësi të Blerësit në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 7



Dispozitat e fundit

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kontrata redaktohet ne dy kopje origjinalë konform rregullave dhe ligjeve dhe me vullnet të lirë nënshkruhet nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI

Vladimir Lleshaj



BLERESI

Shoqeria B-Ideal Group

e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj

